

---

**MATERIALE DHE DOKUMENTE**

---

**ARTAN GOGA****TË DHËNA RRETH FJALORIT SHPJEGUES TË SOTIR PECIT**

Një ndër figurat më të shquara të publicistikës, të arsimit e të kulturës shqiptare, të lëvizjes për çlirim e zgjim kombëtar në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, është pa dyshim edhe Sotir Peci. Ai lindi në Dardhë të Korçës në vitin 1873, pesë vjet përpara krijimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Pasi kryen studimet e larta për matematikë në Athinë, emigron në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku vendoset në kryeqendrën e emigracionit shqiptar, në Boston. Pikërisht në këtë qytet, në vitet 1906-1908, Peci boton gazetën “Kombi”, që përkrah gazetave e revistave të tjera, si “Albania” e Faik Konicës, “Fiamuri i Arbërit” e De Radës, “Dielli” etj., u bë tribunë e debateve për çështjet dhe interesat më jetike të shqiptarëve, ndër të cilat edhe ato që kishin të bënin me gjuhën shqipe. Në vitin 1908 Sotir Peci ishte delegat i shqiptarëve të Amerikës në Kongresin e Manastirit, ku mbron mendimin për nevojën që shqipja të ketë një alfabet të vetëm. Pas këtij kongresi vendos të qëndrojë në atdhe. Është ndër mësuesit e parë të Normales së Elbasanit e më pas drejtor i shkollës “Mësonjëtorja e parë shqipe” në Korçë. Në këtë periudhë harton disa tekste shkollore, ndër të cilat edhe një gramatikë të shqipes. Qeveria e Ismail Qemalit i beson detyra të ndryshme në fushën e arsimit, ndërsa në qeverinë e Sulejman Delvinës të dalë prej Kongresit të Lushnjës zgjidhet ministër arsimit, detyra këto që do t’i kryejë me përkushtimin e spikatur të njeriut që beson se vetëm drita e dijes dhe e kulturës ndriçon rrugën e një kombi drejt përparimit e mbrothësisimit. Pas ngjarjeve të vitit 1924 largohet përfundimisht nga Shqipëria e rikthehet në Shtetet e Bashkuara, gjithë pa e ndërprerë veprimtarinë e vet atdhetare. Ndër të tjera do të vijojë punën për hartimin e një fjalori shpjegues të shqipes, punë që, siç del nga shënimet në dorëshkrimin e këtij fjalori që ndodhet në Arkivin Qendror të Shtetit, e kishte nisur që në vjeshtë të vitit 1916 në Shkodrën e pushtuar prej austro-hungarezëve, ku ai ndodhej për të ndihmuar për mësimin e shqipes aty, dhe do ta vijonte deri në fund të jetës. Për nevojën e një fjalori shpjegues të shqipes flitej herë pas here në shtypin e kohës, krahas dhe lidhur edhe me çështjen e gjuhës letrare kombëtare. Kështu, që në një artikull të “Kombit” në vitin 1907, me gjasë shkruar prej vetë S. Pecit, përveçse flitet për

çështjen më të ngutshme, çështjen e alfabetit, hidhet edhe ideja e krijimit të një fjalori e të një gramatike të shqipes. As “Fjalori” i Kristoforidhit, me gjithë vlerat e tij dhe përpjekjet për ta transkriptuar e përkthyer, punë së cilës iu përkushtua edhe Peci, e as fjalorët dygjuhësh që vijuan, nuk mund t’i përmbushnin nevojat e shqiptarëve për të pasur një vepër që do të ishte një pasqyrë sa më e plotë e leksikut, frazeologjisë e semantikës së gjuhës së tyre. Ndaj për këtë qëllim u ndërmorën nisma nga autorë të ndryshëm, që sollën si fryt të tyre një radhë fjalorësh. Por pjesa më e madhe e tyre mbetën në dorëshkrim, fat të cilin e pati edhe fjalori i Sotir Pecit.

Afërmendsh, hartimi i çfarëdolloj fjalori është një ndërmarrje e vështirë, aq më tepër kur vjen fjala te një fjalor shpjegues i një gjuhe pa histori të gjatë shkrimi e me një variant letrar të vetëm ende të pakristalizuar mirë, me gjithë vijën përafruese që po ndiqnin dialektet, si edhe në kushtet e një tradite leksikografike jo fort të pasur e të një mendimi teorik leksikografik që ende nuk ishte zhvilluar në shkallën e duhur për hartimin e një fjalori të tillë. Në rastin e Sotir Pecit këtyre vështirësive u shtohet edhe fakti që pjesën më të madhe të punës për hartimin e fjalorit ai e kreu në mërgim, larg prej truallit ku gjuha flitej e pastër dhe burimore, pa pasur kështu mundësi të vijonte deri në fund çka kishte nisur kur ishte në Shqipëri: qëmtimin e fjalëve e të shprehjeve nga vetë goja e popullit. Ndaj për fjalorin e Pecit vlejnë përgjithësisht po ato vërejtje që mund të bëhen për të gjithë fjalorët e hartuar në këtë periudhë, qoftë edhe dygjuhësh. Kështu, para së gjithash mund të qortohet mbështetja te fjalorët e mëparshëm pa një tëharrje e verifikim të thellë të lëndës duke u mbështetur në gjuhën e gjallë, gjë që krijonte një qerthull të mbyllur e madje sillte ndonjëherë që i njëjti gabim të kalonte prej një fjalori te tjetri, duke arritur deri edhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” të vitit 1954. I tillë është rasti i emrit “ag”, të cilin si në fjalorin e Pecit, ashtu edhe në fjalorin e 1954-s, e gjejmë të shpjeguar me “errësirë”, gabim që, siç vë në dukje Filip Ndocaj, ka gjasa të ketë ardhur nga shfrytëzimi mekanikisht i “Fjalorit” të “Bashkimit”, i cili e përkthen “ag” me “oscurro” [(i, e) errët] të italishtes, teksa është fjala - siç jepet me të drejtë te Gazulli a në fjalorët e mëpasshëm shpjegues të shqipes të 1980-s e 1984-s - për atë pjesë të ditës kur drita sapo ka dalë, por ende nuk shihet mirë. E metë tjetër e këtyre fjalorëve është përpjekja për të mbuluar mangësitë e materialit të vjelë drejtpërdrejt në popull me neologjizma, në një pjesë të mirë kalke ose formime “in vitro”, që sendërgjoheshin pa hetuar nëse gjuha e gjallë e kishte fjalën për atë nocion që kërkohet të shprehet ose pa u mbështetur në frymën e ligjeve të fjalëformimit të shqipes; kjo sillte si rrjedhojë që ato të mos ishin jetëgjata e të mos i kalonin kufijtë e fjalorëve

përkatës. Gjithashtu, edhe trajtimi leksikografik i lëndës çalonte, kishte plot pasaktësi e moskonsekuenca. Këto e ndonjë arsye tjetër bënte që vlera e këtyre fjalorëve, siç vëren edhe prof. Jani Thomai<sup>1</sup>, të qëndronte më shumë në nxjerrjen në dritë të lëndës leksikore e frazeologjike që ishte arritur të mblidhej në terren, në “strehimin” - po të përdorim një figurë që e ndeshim gjerësisht në artikujt e viteve '50 për fjalorët - e kësaj lënde, për ta shpëtuar atë nga humbja e pakthyeshme e për t'ua lënë brezave të mëvonshëm të leksikografëve e punëtorëve të tjerë të gjuhës. Sidoqoftë, lipset të spikatim se duhet mbajtur parasysh që një pjesë e vërejtjeve konkrete që mund t'i bëhen fjalorit të Sotir Pecit vjen ngase ai ka mbetur në dorëshkrim e, siç thuhet në shënimin e dosjes përkatëse në AQSh, “i papërfunduar”, ndonëse pas vdekjes së autorit theksohej në shtyp se ai e kishte përfunduar fjalorin dhe bëhej thirrje për të krijuar mundësinë që kjo vepër të botohej.

Sipas një vlerësimi të përafërt që kemi bërë, fjalori i Sotir Pecit përmban rreth 15 mijë fjalë-tituj, po të mos merren parasysh variantet fonetike, dhe rreth 21 mijë kuptime. Një arsye për këtë raport relativisht të vogël *njësi semantike - njësi leksikore* është edhe numri i madh i termave në fjalës, sidomos nga fusha e kimisë, e botanikës, zoologjisë, mjekësisë, financës, gjuhësisë, retorikës, muzikës etj., që duket se janë marrë kryesisht nga një “Larousse” i frëngjishtes (2), mbi bazën e të cilit Peci ka hartuar edhe një variant të fjalorit të vet. Ngjan kësisoj se autori i ka mëshuar shumë funksionit informues praktik të fjalorit, duke pasur parasysh edhe kategori të caktuara përdoruesish, si për shembull shkollarët, në kushtet kur as që mund të bëhej fjalë për fjalorë të veçantë terminologjikë. Megjithatë, nëse marrim shkronjën A për shembull, do të gjejmë në të terma specialë, me përdorim të

<sup>1</sup> J. Thomai: “Zhvillimi i teorisë dhe i praktikës leksikografike shqiptare pas Çlirimit”, në *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II*, f. 367-389.

<sup>2</sup> Kemi arsye të besojmë se, përveç lëndës që mundi të vilte nga goja e popullit, si dhe nga shtypi, letërsia artistike e ndonjë burim tjetër, në një pjesë të madhe Peci u mbështet mbi fjalorët ekzistues të kohës. Në arkivin e tij në AQSh ekzistojnë dosje me shënime në formë fjalori të nxjerra pikërisht nga ky “Larousse”, nga “Fjalori etimologjik” i Gustav Majerit, nga “Fjalori gjermanisht-shqip” i Maria fon Godinit e nga një fjalor italisht-shqip, po mund të themi pa frikë se ai shfrytëzoi edhe “Fjalorin” e Kristoforidhit, për përshtatjen e të cilit, siç e përmendëm, edhe punoi, si dhe “Fjalorin” e shoqërisë “Bashkimi”.

kufizuar në një fushë të veçantë të dijës, si: *adagio*, *adherencë*, *adiopozë*, *aerofagji*, *aerofob* e *aerofobi*, *alfenidë*, *aloe*, *aluvion*, *allotropi*, *akrostik*, *arithmograf* etj., po jo fjalë e terma si *i acartë*, *agrume*, *akuzë*, *albanolog* e *albanologji*, *anash* e *anës*, *i ardhshëm* etj.; te B-ja do të shohim se janë përfshirë *badianë*, *bakteriotherapi*, *barit*, *baritinë*, *baroskop*, *bazidë*, *belemmt*, *belladonë*, *benzoat*, *benzoinë*, *bibazik*, *bifid*, *bikonkav*, *bikromaks*, *biplan* etj., po nuk gjejmë *bakall*, *bakllava*, *baladë*, *ballkanas*, *ballkanolog* e *ballkanologji*, *i bashkuar*, *befasi*, *betejë*, *bind* dhe *i bindur*, *blu*, *borgjez* etj., e kështu me radhë mund të vazhdonim për çdo shkronjë. Po ashtu, në fjalor autori ka përfshirë emrat e banorëve sipas shteteve e kontinenteve, por jo emrat e banorëve sipas fshatrave, qyteteve a krahinave të Shqipërisë. Mendojmë gjithashtu se do të ishte mirë të shmangeshin një numër huazimesh, veçanërisht prej gjuhëve neolatine, të cilat duhet të jenë marrë edhe këto prej fjalorit të frëngjishtes që përmendëm pak më lart e që i përkasin kryesisht leksikut të përgjithshëm abstrakt, si *admetoj* e *akseptoj* për “pranoj”, *anticipoj* “bëj para kohe; hershoj”, *apresioj* “çmoj; vlerësoj”, *aprosimatif* “(i, e) përafërt”, *dezideratë* “dëshirë”, *decembre* “dhjetor”, *definitoj* “përcaktoj; përkufizoj”, *eleksion* “zgjedhje” etj., por ndonjëherë edhe leksikut konkret, siç janë për shembull emrat *gant* “dorezë; dorashkë” dhe *garafe* “kanë”. Për t’u lënë jashtë fjalorit janë edhe një varg anglicizmash, si *agrement*, *bankrutë* etj.; turqizmesh: *afqollë*, *aksem*, *alipsan*, *beledije*, *betek*, *bezisten* etj.; greqizmesh: *amortis*, *baxhulidhe*, *daksafis*, *dhrom* etj.; sllavizmash: *dobarem*, *dost*, *kokoshinë*; *izvor* etj. Por, nga ana tjetër, ndonjëherë duket vëmendja e autorit për pastërtinë e gjuhës. Kështu, zërin e fjalorit *aksent* ai e shpjegon me sinonimin shqip “thekës” (theks), për fjalën ardhur nga frëngjishtja *asamble* ka sajuar “bashkëndenjë” etj., e cila, bashkë me një varg fjalësh a neologjizmash të tjerë, si *afërtinë* “rrethinë”, *blem* e *blimet* “treg, pazar”, *bakeq* “ay që zakonisht ban punë të këqija”, *çfisëroj* e *çfisoj* “përdhos, çorodit, bastardoj”, *dhengricë* “mineral, xehe, madem, minë”, *dheor* “që i përket dheut”, *dhëmboj* “armatos me dhëmbë, i ve dhëmbë një sendi; pres një sent në trajta të dhëmbëvet” etj., për një arsye a një tjetër nuk kanë mbijetuar.

Në fjalor janë pasqyruar gjerë disa klasa fjalësh, si fjalët e prejardhura me prapashtesat zvogëluese **-zë** e **-th**: *cazë* “ca, pak”, *copëzë* “copë e vogël”, *cipëzë* “cipë e hollë shumë”, *capth* “cap i vogël”; një varg fjalësh të formuara me ndajshitesa e sindajshitesa, si ndajfoljet me **-isht**: *abstraktisht*, *absurdisht*, *anarqisht*, *bindësisht*, *mbrothësisht*; emrat e mbiemrat me **-uer** (**-or**): *akullore*, *aratore*, *dhëmtor* (mb.), *dheor* “që i përket dheut”; me **-tar**: *adhurimtar*; formimet me sindajshitesat **anti-**, **bashkë-**, **vetë-** etj.

Përgjithësisht në fjalor shfrytëzohen përkufizimet me shpjegim ose me sinonim, ndonëse jo rrallë gërshetohen të dyja: jepet një herë sinonimi ose sinonimet e fjalës-titull, pastaj shpjegimi i saj; ose bëhet shpjegimi, pastaj renditen sinonimet, po atëherë këto të fundit jepen më shumë si informacion shtesë sesa si pjesë e përkufizimit, ashtu siç ndodh nganjëherë edhe me antonimet. Në këto raste përdoren përkatësisht shkurtimet *sin.* e *ant.* Ndodh edhe që shpjegimi të bëhet me një varg relativisht të gjatë sinonimik, duke përfshirë në të variante fonetike dialektore ose njësi krahinore, huazime etj., në disa raste me largësi kuptimore të përfillshme, duke e errësuar kështu kuptimin e fjalës në vend që ta ndriçojnë atë. Shpesh sinonimet kanë shpjegime simetrike, duke mos përcaktuar kështu mbizotëruesin (dominantin) e duke u dhënë të njëjtën peshë edhe atëherë kur nuk e kanë në të vërtetë atë. Nga ana tjetër, ndonjë sinonim që shërben për përkufizim, nuk e gjejmë si fjalë-titull. Sa u përket shpjegimeve, ato përgjithësisht janë të thukëta, por nuk mungojnë rastet kur nuk janë gjuhësore, por enciklopedike. Madje për fjalë si *algjebër*, *alfabet*, *ballon*, *çaj*, *dhe*, *gjak*, *qeramikë* etj. jepet një informacion i gjerë në fund të zërit përkatës. Përgjithësisht në ndërtimin e strukturës kuptimore merret parasysh hierarkia sipas dendurisë së përdorimit ose prejardhjes semantike, po sigurisht një gjë e tillë është e vështirë të bëhet gjithëherë. Kuptimet e figurshme jepen zakonisht të fundit. Shpesh kuptimet ilustrohen me shembuj. Gjithashtu në artikull jepen edhe thënie të lira e të qëndrueshme, frazeologji e herë-herë edhe fjalë të urta. Shpjegimet tipësore janë të pakta, përgjithësisht për ndonjë klasë të veçantë fjalësh, si p.sh. për ndajfoljet e formuara me **-isht**. Tek-tuk ndeshen edhe gabime, veçanërisht ato që lidhen me tipin kategorial të shpjegimit, si në rastet kur folja shpjegohet si emër, p.sh. “bakrosem”, për të cilën hasim përkufizimin: “Thohet për oksidet e bakërit që zenë enët e pakallaisura mirë” (pa përmendur këtu faktin që kjo folje e të tjera si ajo që ndeshim në fjalor, për shkak të semantikës me të cilën paraqiten, nuk mund të kenë vetë të parë e kësisoj nuk mund të paraqiten në këtë trajtë si fjalë-titull); ose kur mbiemri shpjegohet si emër: *befun* (*i*, *e*, *të*) “shfaqje, mrritje pa pritun, pa kujtunum” etj. Por edhe në vetë përmbajtjen e përkufizimeve ndeshen pasaktësi. Kështu, kuptimi i *banknotës* në fjalor del “kartmonedha e Anglisë, e Amerikës etj.”, kur dihet se bankënota është një kartëmonedhë, siguruese e së cilës është banka, ndonëse fillimisht mund të jetë përdorur pikërisht në Angli e në ShBA. Ndërsa *dhrom*, që siç e përmendëm më sipër është një huazim nga greqishtja, përkufizohet si “udhë prej një vendi në një vend tjetër”. Sigurisht këtu kemi të bëjmë me një pleonazëm, sepse dihet që çdo udhë shkon nga një vend në një vend tjetër. Fakti që kjo fjalë e huaj nuk i sjell ndonjë nuancë të re sistemit semantik të shqipes është një argument

tjetër për ta vlerësuar atë si të panevojshme e për të mos e përfshirë në fjalor.

Autori nuk ka ndjekur të njëjtën vijë as në paraqitjen e çerdheve të fjalëve. Një herë ato janë dhënë në arkitekturën kuptimore të fjalës-titull, një herë më vete. Ndeshen edhe raste kur, bie fjala, një kompozitë si *ballëhapët* shpjegohet brenda strukturës së *ballë*, pastaj vijohet sërish me kuptimet e bashkëlidhjet e kësaj të fundit, duke krijuar kështu pështjellim, teksa në shumicën e rasteve fjalët e përbëra dalin si zëra të veçantë, si edhe kur një fjalë shpjegohet brenda një fjale-titull tjetër, siç është rasti me *cull*, që e gjejmë të përkufizuar brenda zërit *baltë*.

Po ashtu gjen mangësi edhe në pasqyrimin e trajtave veprorë e të trajtave pësore të foljeve. Ato jepen si rregull veç njëra-tjetrës, po jo rrallë rastis që të vendoset vetëm trajta veprorë, pa pësoren, e ndonjëherë edhe e anasjella.

Fjalësi është i mbushur me trajta fonetike dialektore, e kuptueshme kjo për fazën e standardizimit ku ndodhej shqipja, por edhe ngaqë duket se autori ka synuar ta bëjë sa më gjithëpërfshirës fjalorin. Sidoqoftë, sërish ai nuk ka qenë krejt konsekuent në paraqitjen e këtyre varianteve. Ato herë jepen në trajtën “a dhe b”, si p.sh. “*bedhoj* dhe *bidhoj*”, “*bec* dhe *beckë*”, “*fortunë* dhe *furtunë*”; herë si “a shih b” ose “a shih b, c”, si të “*dhampir* shih *vampir*”, “*cvarrë* shih *svarrë*, *xvarrë*” etj., duke u mbajtur kështu njëfarë qëndrimi normativ, ndërsa herë-herë shpjegohen dy a më shumë variantet e fjalës, gjithë këto pa ndonjë kriter të hetueshëm lehtë.

Autori ka bërë përpjekje edhe për shtresëzimin e leksikut me anë të shënimeve plotësuese. Kjo është bërë përgjithësisht e plotë te termat, ku jepet fusha e shkencës së cilës i përkasin ata, por tek-tuk edhe për huazimet e fjalët krahinore. Por edhe këtu ai nuk i ka shpëtuar ndonjë pasaktësie. Kështu, për fjalën *carruvi* jepet shënimi se i përket së folmes së Elbasanit, megjithatë në shembullin ilustrues (*Nuk e bënë atë punë, se u duall shumë carruvi*) dalin trajta të së folmes së Devollit, duke e vënë kështu në dyshim njëmendësinë ose të shënimit, ose të shembullit.

Megjithatë, besojmë që një pjesë fjalësh kanë kuptime e ngjyime kuptimore të cilat do ta pasuronin sistemin leksikor e semantik të gjuhës së sotme letrare e mund të përfshiheshin në fjalorët shpjegues të ardhshëm. Të tilla mund të ishin: *agoj* “çohem shumë herët në agim”; *aht* “hidhnim që ndien njeriu për një të keqe, dam, padrejtësi, të fymë që i ka bamun dikush”; *anamendas* “që e ka më dysh mendjen, që nuk merr vendim”; *ballësoj* “i ve për ballë të dy anët e një gjaje dhe ndë një lik; i ballësoj të dy kornizat”; *barrore* “samar”, *bleshëm (i)* “që mund të blihet me pare” (mbiemër që

mund të niste fort mirë të përdorej në vend të huazimit “i korruptuar”, siç e tregon edhe shembulli i zgjedhur nga autori dhe shpjegimi i dhënë për të: *nëpunës i bleshëm* “ai që për të holla bën punë që janë në kundërshtim me moralin ose ndërgjegjen”); *caprruk* “njeri i shkurtër me fytyrë komike ose të shëmtutë”, *cepekët (i, e)* “tullac, pa lesh ose me pak qime ndë krye”, *dhilë* “lodhje e madhe, raskapitje, mungesë fuqije”, *grymtë (i)* “i keq, zemërlig” etj. Nëse kjo që thamë pak më lart është e vërtetë, atëherë jemi të bindur se pikërisht këtu qëndron vlera dhe arritja më e madhe e këtij fjalori.

#### ABSTRACT

Sotir Peci is one of the most eminent figures of the Albanian struggle for freedom and national prosperity in the first half of the 20<sup>th</sup> century. Among other things, he realized the need for a dictionary that would include and preserve as much as possible from the lexical, semantic and phraseological richness of the Albanian language. Despite dictionary's flaws that reflect the level of lexicographical theory of that time, Peci's attempt is to be congratulated. Some of the word entries of his dictionary that has remained still unpublished, like *agoj*, *anamendas*, *ballësoj*, *bleshëm (i)*, *dhilë*, *grymtë (i)*, etc., may enrich the semantic and lexical system of the Albanian literary language, therefore the author of this paper express the idea that they should be included in the contemporary Albanian dictionaries.

